

Shtojca 2

DEKLARATË

Për konfliktin e interesit

Deklarata e kërkesës së operatorit ekonomik në procedurën e prokurimit publik të zhvillohet në datën _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrimeve publike dhe interesave private tek një zyrtar, nëse ai ka një interes privat, nëse drejtohet nga drejtori me ndikim, mund të ndikojë për të kryer detyrat dhe detyrimet publiku i tij.

Në mbështetje të nenit 21 pika 1 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve të përcaktuara në kreun III, seksioni II, të cilëve u ndalohet absolutisht të përfitojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga lidhja e kontratave me një palë në një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministra ose zëvendësministra, deputetë, gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, gjyqtarë dhe prokurorë në shkallën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarë të Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë, ku përfshihen Guvernatori dhe Zëvendësguvernatori; konkurrenca, telekomunikacioni; energjia; furnizimi me ujë; sigurimet; letrat me vlerë; media); publik, i cili është të paktën i barabartë në pozicionin e drejtorëve të përgjithshëm, drejtuesve të institucioneve administrative, ministrive publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues, sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut III, pika 2, të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm për lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe juridiksionit të institucionit ku punon zyrtari. Ky ndalim vlen edhe kur pala është institucion varësie.

Kur zyrtari është në funksion të kryetarit ose të nënkryetarit të bashkisë, këshillit të komunës ose qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është funksionar i lartë i njësisë së qeverisjes vendore, ndalimi për interesa private të zyrtari, i përcaktuar në këtë pikë, zbatohet vetëm për lidhjen e kontratave, sipas rastit, me këshillin e bashkisë, komunës ose qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen njëjloj për personat e lidhur me zyrtarin, të cilët në kuptim të këtij ligji janë bashkëshorti, bashkëjetuesi, fëmijët madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit dhe bashkëjetuesi.

Unë, i nënshkruari _____, në cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____, deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to, deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në Kreun III, Seksioni II i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë zotëron interesa private drejtpërdrejt ose tërthorazi me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Firma

Vula
